



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Vendim

Nr. 27 Date 22.09.2017

**"Për miratim të Lejes së Përdorimit të Ujit
për prodhim të energjise elektrike, nëpërmjet ndërtimit të
të HEC“ Mushtri ”, Fan i Vogël, degë e Lumit Mat në Fshatin Mashtërkorë/ Bashkia Mirditë, Qarku
Lezhë nga Subjekti “Liriinvest” sh.p.k**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, “Per miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”(i ndryshuar) si dhe miratimit paraprak miratimit paraprak Nr.2057/4 Date 28/07 /2016 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, me propozim të A.B.U. Mat, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

Vendosi:

1. MIRATIMIN e Lejes për Përdorim të Rezervave Ujore për prodhim të energjisë elektrike, nëpërmjet ndërtimit të HEC “ Mushtri ” në Njësinë Administrative Orosh, Bashkia Mirditë në Qarkun **Lezhë** të rrjedhës së lumit **Fan i Vogël degë e Lumit Mat**, Subjektit “**Liriinvest**” sh.p.k, me Administrator Z. Giuseppe FAVA,

-Subjektit juridik/fizik “LIRIINVEST” shpk:

-Prurja mesatare : Q= 7.62 m³/sek,

-Prurja llogarites: Q= 8.4 m³/sek,

-Prurja ekologjike: Q= 0.616 m³/sek,

-Prurje per perdorime te tjera: _____ m³

-Energjia e planifikuar vjetore: 8 320 782 kwh/vit,

- Fuqia 1985 kw, ore pune/vit _____

-Kuota e veprës së marrjes Z=355 m X-44 25 236 Y-46 39 402

-Kuota e godinës së centralit: Z= 300.95m. X- 44 23 875 Y- 46 39 044

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes, i furnizimit me ujë të popullatës etjerë nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT

Ast **NIKOLKA**



KRYETARI I K.B.U. MAT

Eduard NDRECA

